



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 Qershor 2008, nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në bazë të nenit 12, dhe nenit 17 paragrafi 1, shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, në nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 duke u bazuar në Shkresën përcjellëse të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nr. 4380-2/25 të datës 12.06.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _____ miratoi këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR ANULIMIN E VENDIMIT 15NR.352/05-27004 I DATËS 29.05.2025 PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VARREZA NË FSHATIN QYLAGË

Neni 1

Me këtë Vendim **ANULOHET**, Vendimi 15Nr.352/05-27004 i datës 29.05.2025, për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qylagë.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Statutit të Komunës së Lipjanit si dhe në Shkresën përcjellëse të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr.4380-2/25 të datës 12.06.2025.

Me Shkresën përcjellëse të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është kërkuar rishqyrtimi i ligjshmërisë së aktit të lartë duke kërkuar që i njëjti të jetë i bazuar në dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës dhe njëkohësisht kanë kërkuar nga Komuna që ta përmbyll procesin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).

Përkitazi me këtë konsiderohet e arsyeshme që të bëhet anulimi i Vendimit të cekur deri në finalizimin e Planit Zhvillimor të Komunës (PZHK).

Nga të cekurat më lartë kërkohet nga Kuvendi i Komunës që me qëllim të përmbushjes së Rekomandimeve të MMPHI deri në finalizimin e Planit Zhvillimor të Komunës (PZHK) të bëjë miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 353/01-30269
Lipjan, më 18.06.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

Njësia rap.
Org./Instituc.
Org./Unit
Nr./Faqeje
Dre./Stranica
Nad/Pages

06
-02-

Nr./Prot.
Proj./Prot.
Prot. No.
Data/
Datum/
Date

4380-2/25
12.06.25

PRISHTINË / A

No 1

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në Detyrë në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër në Detyrë në MMPHI Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Shendrita Latifi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit dhe Mbështetjes Ligjore
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 15-352/05-27004 për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qyllagë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, datë 29.05.2025

I nderuar Kryetar Ahmeti,
I nderuar Kryesues Azemi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 02.06.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin Nr. 15-352/05-27004 për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qyllagë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, datë 29.05.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Lipjanit:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimin Nr. 15-352/05-27004 për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Qyllagë, miratuar nga Kuvendi Komunal i Lipjanit, datë 29.05.2025.

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Përcaktimi i lokacionit për shfrytëzimin e një zone apo nën-zone të caktuar, sipas këtij vendimi, duhet të bazohet në dokumentet e planifikimit hapësinor të Komunës së Lipjanit. Ky vendim duhet të përfshijë pjesën tekstuale dhe hartografike të dokumentit në fuqi, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, në të cilin mbështetet vendimi.

Për këtë arsye, inkurajojmë Komunën e Lipjanit që të përmbyllë sa më shpejt procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), në mënyrë që kërkesa të tilla të adresohen në përputhje me dokumentet e planifikimit hapësinor. Gjithashtu, gjatë përcaktimit të nevojave për zgjerimin e infrastrukturës publike, duhet të respektohet Ligji për Tokën Bujqësore, duke ruajtur cilësinë dhe bonitetin e tokës bujqësore – si në këtë rast, ku toka i përket kategorisë së dytë – me qëllim të mbrojtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.